



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2021:244911

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05686028

**PPP.nr.1128/21**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil** përmbartimore, me gjyqtarin Genc Hasani, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Berisha, në çështjen juridike të kreditorit M. Zh. nga M., kundër debitorit S. L. Sh,a, me numër identifikimi ..., me adrese Rr. Bislim Bajgora - Mitrovice, për shkak të borxhit, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me datë 15.10.2021, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.433/21, të datës 04.10.2021, gjykata jashtë seancës gjyqësore me datë 15.05.2024 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** në tersi si i pabazuar prapësimi i debitorit S. L Sh,a, me numër identifikimi ..., me adrese Rr. Bislim Bajgora - Mitrovice, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.433/21, të datës 04.10.2021, sipas propozimit të kreditorit M. Zh. nga M.

**II.** Mbetet ne fuqi Urdhri përmbartimorë me numër Pnr.433/21, i datës 04.10.2021.

**A r s y e t i m**

Kreditori M. Zh. nga M. ka ushtruar propozimin për përmbartim tek përmbartuesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimi ndaj debitorit S. L. Sh,a, me numër identifikimi .., me adrese Rr. Bislim Bajgora – Mitrovice, në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike në Prishtinë, me numër IV.EK.485/19, të datës 08.05.2020, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin nga mos përmbushja e kontratës të datës 24.03.2017, në shumen prej 15,000.00€, me kamat ligjore 8%, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës në shumen prej 840.00€. nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, të gjitha këto në afat (7) ditor nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përmbartuesi privat me urdhrin P.nr....., të datës ..., ka lejuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Debitori S. L. Sh,a, brenda afatit ligjor me datë 15.10.2021, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar av Mahmut Halimi, ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrit përmbartimor, duke i propozuar gjykatës që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar. Tutje i njëjti thekson se në mbështetje të nenit 76 të Ligjit për procedurën kontestimore parasheh se “Gjykata gjate tere procedurës duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare”, nëse personi që paraqitet si pale mund të jete pale në procedure dhe nëse është me zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjore dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizim të veçante kur ai është i nevojshëm e të cilin

detyrim as gjykata dhe as përmbaruesi privat nuk e kane përmbushur, Se këndejmi duke pasur parasysh se sipas aktgjykimit dhe arsytimit ne te njëjtin vërtetohet se palët kontraktuese kane lidhur kontrate për shitjen e aksioneve dt. 24.03.2017, ne te cilën kreditor paraqitet shitësi i aksioneve, ndërsa blerës te aksioneve janë R. B. dhe I. M., e qe rezulton se ne ketë marrëdhënie kontraktuese debitori fare nuk është pale ne procedure e as qe ka ndonjë detyrim kontraktuale ne ç'mënyrë debitori nuk ka legjitimitet pasiv qe te jete pale ne ketë çështje përmbarimore.

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigje dhe ka kërkuar nga gjykata qe ti refuzoj ne tersi prapësimin, ashtu qe te vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore –Departamenti për Çështje Ekonomike – Prishtine IV UK 485/19.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të.. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se si pale kontraktuese ka lidhur kontrate për shitjen e aksioneve dt. 24.03.2017, ne te cilën kreditor paraqitet shitësi i aksioneve, ndërsa blerës te aksioneve janë R. B. dhe I. M e qe rezulton se ne ketë marrëdhënie kontraktuese debitori fare nuk është pale ne procedure e as qe ka ndonjë detyrim kontraktuale, ne ç 'mënyrë debitori nuk ka legjitimitet pasiv qe te jete pale ne ketë çështje përmbarimore, gjykata një pretendim te tille te debitorit e refuzoj ne tërësi si te pabazuar, duke qene se propozimi për përmbarim është bere ne baze te dokumentit përmbarues dhe Urdhri përmbarimore është lëshuar ne baze te tij, pra ne baze te aktgjykimit të Gjykatës Themelore –Departamenti për Çështje Ekonomike – Prishtine, me nr. ...

Po ashtu gjykata e refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar pasi që vlerësoi se me rastin e inicimit të procedurës përmbarimore në përpikëri janë respektuar dispozitat e nenit 21, 22, 36, 38 dhe 43, ku në nenin 21 parashihet se: bazat juridike për caktimin e përmbarimit "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*", dhe nenin 43 parasheh se Aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim 1. "*Në aktvendimin për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim në bazë të titullit përmbarues duhet të tregohet dokumenti përmbarues, kreditori dhe debitori i përmbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit*". Gjykata po ashtu vendimin e saj e bazoi edhe në dispozitën e nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1, ku parashihet që 1. Dokument përmbarues është: 1.1. "*vendimi përmbarues i Gjykatës*".

Vendimin e saj si në pikën I të dispozitivit te aktvendimit gjykata e bazoi edhe në nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së cituar "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*", ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se "*kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet në përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkoj edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak*".

Vendimin si në pikën II të dispozitivit te aktvendimit e bazoj ne nenin 17 të LPP-së, e në lidhje me nenin 408 te LPK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:244911  
Datë: 15.05.2024  
Numri i dokumentit: 05686028

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**PPP.nr.1118/21, datë 15.05.2024**

**GJYQTARI,**  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.